



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1655 Prot.

Roskovec, më 26 . 02 2026

V E N D I M

NR 8 , DATË 26 . 02 .2026

P Ë R

**NJË SAKTËSIM TË PIKËS III NË VENDIMIN NR.05 DATË 29.01.2026 "PËR MIRATIM FONDESH
SHITESË NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2026"**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 54, të ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjen vendore" neni 46 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar neni 47 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të VKB Nr. 71 datë 24.12.2025 "Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026", VKB Nr.5, datë 29.01.2026 "Për miratim fondesh shtesë në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026" dhe miratimin nga Prefektura me Nr.166/1 Prot., datë 09.02.2026; si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria Ekonomike, Këshilli i Bashkisë,

-VENDOSI :

I. Të miratohet saktësimi i pikës III i vendimit Nr.05, datë 29.01.2026 për fondet e përfituara nga Granti i Bazuar në Performancë (GBP) për Bashkinë Roskovec për vitin 2025, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit në vlerën totale **5,828,911.82** lekë, si më poshtë:

ISHTE:

Të miratojë alokimin e fondeve të përfituara nga Granti i Bazuar në Performancë (GBP) për Bashkinë Roskovec për vitin 2025, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, sipas vendimit përfundimtarë të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, në vlerën totale **5,828,911.82** lekë, për "Restaurimi i shkollës në fshatin Arapaj" me qëllim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe sigurisë së nxënësve. Vlera e plotë e projektit është **9,828,912 lekë me TVSH**, nga e cila 40.69% financohet nga Bashkia Roskovec konkretisht **4,000,000 lekë** e miratuar me VKB Nr. 71 datë 24.12.2025 "Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026" dhe 59.3% do të financohet nga Buxheti i Shtetit me vlerë **5,828,911.82 lekë**.

BËHET:

- **2,606,741.58** (Dy milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzetë e një presje pesëdhjetë e tetë) lekë, **Grant i brendshëm, (00-01-09120-231).**

- **3,222,170,24** (Tre milion e dyqind e njëzetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë presje njëzetë e katër) lekë,

Grant i huaj, (00-02-09120-231).

për “Restaurimi i shkollës në fshatin Arapaj” .Vlera e plotë e projektit është **9,828,912 lekë me TVSH**,nga e cila 40.69% financohet nga Bashkia Roskovec konkretisht **4,000,000 lekë** e miratuar me VKB Nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026” dhe 59.3% do të financohet nga Buxheti i Shtetit me vlerë **5,828,911.82 lekë**.

II. Ngarkohet Administrata e Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka

